REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 06.10.2015, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Arta Dade – kryetare e Komisionit

(Procesverbal i mbajtur me shënime)

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;
2. Seancë informuese me Përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Jashtme lidhur me marrëdhëniet e Republikës së Shqipërisë me Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe projektet e përbashkëta me Agjencitë e kësaj organizate në Shqipëri.
3. Të tjera.

Marrin pjesë:

Arta Dade, Aldo Bumçi, Valentina Leskaj, Vangjel Dule, Luljeta Arapi, Edlira Çekrezi, Eduard Selami, Kastriot Islami.

Mungojnë*:*

Namik Dokle, Ben Blushi, Perparim Spahiu, Jozefina Topalli, Shpëtim Idrizi.

Të ftuar:

1. Z.Qirjako Qirko - Sekretar i Pergjithshem, Ministria se Punëve te Jashtme;
2. Z. Sokol Gjoka - Drejtor i Përgjithshëm i Çështjeve Politike e Strategjike, Ministria e Punëve të Jashtme.
3. Znj.Venera Domi- Drejtoria e Organizatave Ndërkombëtare, Ministria e Punëve te Jashtme

HAPET MBLEDHJA

Arta Dade: Duke ju uruar një ditë të mbarë, i uroj mirëseardhjen përfaqësuesve të Ministrisë së Punëve të Jashtme Z.Qirjako Qirko - Sekretar i Përgjithshëm, Ministria se Punëve te Jashtme, Sokol Gjoka - Drejtor i Përgjithshëm i Çështjeve Politike e Strategjike, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Znj. Venera Domi- Drejtoria e Organizatave Ndërkombëtare, Ministria e Punëve te Jashtme. Ju falënderoj që ju kemi përsëri këtu sot pas një mbledhje shumë të frytshme dje, shkëmbyem mendime të vyera lidhur me marrëdhëniet e Republikës së Shqipërisë me OSBE-në gjithashtu dhe me Këshillin e Europës.

Sot do të marrim informacion dhe do të diskutojmë rreth marrëdhënieve të Republikës së Shqipërisë me Organizatën e Kombeve të Bashkuara, për rolin që Shqipëria luan në këto organizata dhe gjithashtu marrëdhëniet e Republikës së Shqipërisë me agjencitë e pranishme në Tiranë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, projektet e përbashkëta dhe çfarë pozitiviteti ka sjellë në përgjithësi në konsolidimin e demokracisë së shtetit ligjor dhe të avancimit në agjendën tonë europiane, sepse dihet që të gjitha këto organizma të pranishme në Tiranë kanë mbështetur ecurinë tonë në proceset integruese.

Zoti Qirko keni fjalën.

Qirjako Qirko: Faleminderit zonja Kryetare! Të nderuar anëtarë të Komisionit të Jashtëm

Më lejoni që në emër të kolegëve të mi, t'ju falënderoj për ftesën duke vlerësuar veçanërisht rolin dhe kontributin që Komisioni i Jashtëm ka në drejtim të politikës sonë të jashtme. Gjuhën e mirëkuptimimit që kemi gjetur përgjithësisht për të gjitha çështjet që kemi diskutuar. Më lejoni të prezantoj një material të përgjithshëm lidhur me angazhimin e vendit tonë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe më tej për një informacion më të detajuar për angazhimin në këto organizata, për angazhimin e agjencive të kësaj organizatë në vendin tonë do t'ju informojë zoti Gjoka dhe më tej do të jemi të hapur për pyetjet.

Në këtë përvjetor të 70 të krijimit të OKB-së dhe 60-vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në këtë Organizatë vendi ynë ka rritur ndjeshëm praninë dhe kontributin e vet në kuadër të OKB-së. Shqipëria ka nisur gjatë këtij viti anëtarësimin 3-vjeçar në Këshillin e të Drejtave të Njeriut në Gjenevë, një nga organet kryesore të OKB-së, duke mbajtur për këtë vit dhe pozicionin e Zëvendëskryetarit të Këshillit. Gjithashtu edhe në vitin e dytë të anëtarësimit në Këshillin Ekzekutiv të UNESCO-s ku jemi dhe zëvendës president të Këshillit. Anëtarësimin

në Komisionin për Statusin e Gruas dhe pjesëmarrja jonë e suksesshme në iniciativën Një OKB.

Me rëndësi paraqitet pjesëmarrja e delegacionit tonë në Sesionin e 70 të Asamblesë së Përgjithshme, Java e nivelit të Lartë dhe aktivitete të ndryshme që u organizuan përpara dhe gjatë kësaj jave. Vlen të theksojmë pjesëmarrjen e suksesshme në Samitin për Zhvillimin e Qëndrueshëm i cili miratoi 17 objektiva globale dhe 167 synime të zhvillimit të qëndrueshëm në traktatin e nivelit të lartë për barazinë gjinore, në samitin kundër terrorizmit drejtuar nga Presidenti Obama si dhe shumë side evente të organizuara gjatë kësaj jave. Një vend të posaçëm zë organizimi nga vendi ynë në bashkëpunim me Jordaninë dhe me Selinë e Shenjtë të një aktiviteti të nivelit të lartë për tolerancën. Gjithashtu delegacioni zhvilloi dhe një sërë takimesh dypalëshe. Në kuadër të Këshillit të Drejtave të Njeriut vendi ynë gjatë tre sesioneve të këtij viti, pra 28, 29, 30 u fokusuan në luftën ndaj fenomeneve lidhur me ekstremizmin e dhunshëm, promovimin e tolerancës dhe bashkëjetesës paqësore midis dy komuniteteve, barazia gjinore, të drejtat e fëmijëve, mosdiskriminimi dhe angazhimi kundër dënimit me vdekje.

Qëndrimet e vendit tonë gjatë tre sesioneve të këtij viti janë vlerësuar nga aleatët dhe partnerët tanë dhe kanë qenë pozitive, të ekuilibruara dhe në linjë me interesat madhore të vendit tonë.

Një angazhim madhor i politikës sonë të jashtme në kuadër të sistemit të OKB-së është mbështetja e kandidaturës së Kosovës në UNESCO. Kjo fushatë po sheh angazhimin total të sistemit të shërbimit të jashtëm të Republikës së Shqipërisë në bashkëpunim me palën Kosovare.

Programi i bashkëpunimit me OKB-në në kuadër të Delivering as One, ka qenë dhe do të mbetet i fokusuar në prioritetet e vendit tonë në kuadër të forcimit të demokracisë, shtetit të së drejtës, luftës kundër korrupsionit dhe trafiqeve dhe zhvillimit social dhe ekonomik të vendit. Ai reflekton prioritetet e vendit tonë në drejtim të anëtarësimit tonë në BE dhe i ka shërbyer dhe i shërben këtij prioriteti madhor.

Do më lejoni për një informim më të detajuar për sa përmenda shkarazi, zoti Gjoka.

Arta Dade: faleminderit zoti Qirko. Po zoti Gjoka.

Sokol Gjoka: Përshëndetje! Në vijim të parashtresës që bëri Sekretari i Përgjithshëm unë do të fokusohesha në disa elementë kryesorë. Do ta filloja me punën e delegacionit tonë në Asamblenë e Përgjithshme të këtij viti, në sesionin e 70, për të kaluar më pas tek UNESCO dhe tek aktivitete të tjera të OKB-së dhe të agjencive përkatëse.

Gjatë sesionit të 70-të të Asamblesë së Përgjithshme, në ndërhyrjet, fjalimet, debatet, takimet, në tërësinë e aktivitetit gjatë Javës së Nivelit të Lartë e më tej, gjatë punimeve të sesionit, akset kryesore të aktivitetit të Shqipërisë në OKB ishin:

1. Forcimi i paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.
2. Bashkërendimi i përpjekjeve kundër terrorizmit ndërkombëtar.
3. Nxitja dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut.
4. Zhvillimi i qëndrueshëm.
5. Ndryshimet klimatike.

Si dhe:

6. Forcimi i bashkëpunimit të gjithanshëm rajonal.
7. Mbështetja e Kosovës dhe e përpjekjeve të saj për njohje e integrim ndërkombëtar.
8. Sistemi Një OKB (Delivering as One).

Gjatë Javës së Nivelit të Lartë, Delegacioni ynë zhvilloi aktivitetin më të dendur e më substancial në historinë e pjesëmarrjes së vendit tone në OK, që koincidoi edhe me 60 vjetorin e anëtarësisë së Shqipërisë në këtë organizatë. Përtej aspekteve të pjesëmarrjes së delegacionit tonë në aktivitetet e OKB-së sipas agjendës së Asamblesë së Përgjithshme Delegacioni ynë organizoi një numri takimesh dypalëshe në Nivel Kryetari të Delegacionit si dhe në nivel Ministri të Punëve të Jashtme, me përfaqësues nga të gjitha kontinentet.

Gjatë punimeve të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-se, Delegacioni ndërhyri, me fjalime në forma, struktura e nivele të ndryshme, në 15 aktivitete të ndryshme. Kryeministri Rama ishte i vetmi Lider i Rajonit të gjerë të Evropës Juglindore që ishte i ftuar të kontribuonte në Samitin e veçantë të organizuar nga Presidenti Obama mbi kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm, duke i njohur kështu vendit tonë një rol të spikatur në këtë kuadër.

Delegacioni organizoi me sukses, për herë të parë, një Side Event të Nivelit të Lartë, në bashkëpunim me Jordaninë dhe Selinë e Shenjtë si dhe me pjesëmarrjen e 4 organizatave të ndryshme e të njohura ndërkombëtare, duke i dhënë vendit tonë një dimension të veçantë të vlerësuar.

Kryeministri, Ministri i Jashtëm dhe Delegacioni paraqitën në OKB, nëpërmjet ndërhyrjeve të ndryshme, angazhimin e Shqipërisë për të punuar për hartimin e një Karte Globale lidhur me nevojën e përfshirjes në kurrikulat shkollore që në moshë të hershme të mësimeve për të nxitur njohjen dhe respektin për të tjerët, për kulturat e civilizimet, fetë dhe elementët e trashëgimisë kulturore e shpirtërore të të tjerëve, si investim i pazëvendësueshëm për mirëkuptim e respekt.

Delegacioni zhvilloi tre takime të veçanta me zyrtarë të lartë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, shprehje e një tematike bashkëveprimi të zgjeruar mes dy vendeve dhe reflektim e materializim i partneritetit strategjik.

Delegacioni shqiptar zhvilloi po ashtu, për herë të parë, një takim të strukturuar më përfaqësues të një numri organizatash ndër më aktivet e që përfaqësojnë rininë shqiptaro-amerikane në diasporë, nga ku rezultoi edhe angazhimi për organizimin në një të ardhme të afërt, në Tiranë, të Kongresit të Parë të Diasporës shqiptare në Botë.

Në përgatitje të pjesëmarrjes serioze në Samitin për Klimën në Paris (Dhjetor 2015), vendi ynë dorëzoi pranë Sekretariatit të Konventës së OKB për Ndryshimet klimatike objektivat kombëtare për këtë çështje. Dokumenti i objektivave tona parashikon reduktimin e gazrave CO2 me 11.5%, ose 708 ton deri në vitin 2030. Ky objektiv është në linjë me kërkesat e BE-së.

Në kuadër të marrëdhënieve dypalëshe u nënshkruan edhe disa marrëveshje bashkëpunimi me vende të ndryshme.

Pjesëmarrja e vendit tonë në sesionin e 30-të të Këshillit të të Drejtave të Njeriut.

Republika e Shqipërisë, tashmë anëtare e KDNJ-së për periudhën 2015-2017, mbetet e përkushtuar për promovimin universal dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, lirive themelore të tij, si dhe mbështet integrimin e dimensionit të drejtave të njeriut në të gjithë Politikat e Kombeve të Bashkuara. Gjatë anëtarësisë së saj në KDNJ, prioritet e saj janë:

Lufta ndaj fenomeneve të lidhura më ekstremizmin e dhunshëm & Promovimi i tolerancës dhe bashkëjetesës paqësore midis komuniteteve. Shqipëria, duke pasur parasysh vendndodhjen e saj gjeografike, trashëgiminë kulturore dhe tolerancën shembullore që mbizotëron ndër tiparet kryesore të shoqërisë së saj, ka qenë vazhdimisht një promotor i dialogut, respektit dhe nxitjes së bashkëjetesës harmonike në mes besimeve të ndryshme fetare, kulturave dhe civilizimeve.

Shqipëria do të vazhdojë të luajë këtë rol proaktiv edhe në të ardhmen.

Në zbatim të këtij objektivi, gjatë sesionit të 30-të të KDNJ-së, i cili u zhvillua në Gjenevë në datat 14 shtator -2 tetor 2015, Shqipëria ishte në listën e vendeve bërthamë të inicimit dhe miratimit me sukses të një rezolute të re në KDNJ për luftën ndaj ekstremizmit të dhunshëm (CVE).

Shqipëria u angazhua aktivisht në negociatat midis vendeve për definimin e rezolutës në fjalë, duke bërë të mundur miratimin e saj ashtu siç ishte propozuar nga vendet bërthamë.

Shqipëria ka qenë aktive dhe e zëshme për heqjen e dënimit me vdekje. Në zbatim të këtij objektivi, gjatë sesionit të 30-të të KDNJ-së, Shqipëria ajo punoi aktivisht për mbrojtjen e këtij qëllimi.

Të drejtat e fëmijëve, barazia gjinore, mosdiskriminimi, respektimi i të drejtave të minoriteteve kanë qenë disa nga drejtimet e punës që Ministria e Punëve të Jashtme me strukturat e saj ka zhvilluat me organizatën ndërkombëtare, kryesisht në Këshillin e të Drejtave të Njeriut.

Në këtë kuadër Shqipëria ka luajtur një rol të veçantë për ngushtimin e dallimeve midis vendeve Perëndimore dhe atyre të organizatës së Bashkëpunimit Islamik për çka është vlerësuar nga vendet mike dhe partnere.

Fushata lobuese e Shqipërisë për anëtarësimin e Kosovës në UNESCO.

Anëtarësimi i Kosovës në UNESCO konsiderohet si një veprim i një rëndësie të veçantë, mbasi UNESCO është një agjenci e specializuar e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Anëtarësimi i Kosovës në ketë organizate do te jete një sprove e mire për përqasjen graduale te saj drejt vetë Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Procesi i aplikimit për anëtarësimin e Kosovës në UNESCO është ndeshur me vështirësi dhe pengesa të karakterit procedural, nga vetë strukturat e organizatës, të cilat nxirrnin pengesën e kushtëzimit te pavarësisë se Kosovës me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së.

Pasi nuk u mundësua që kërkesa e Kosovës të depozitohet nëpërmjet UNMIK-ut dhe as nga Sekretariati i UNESCO-s për në Bordin Ekzekutiv për ta futur në rendin e ditës së punimeve të Sesionit të 197-të, hapat procedurale për paraqitjen e dosjes u përmbyllën nga Republika e Shqipërisë.

Gjate kësaj kohe, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve te Jashtme të Kosovës është zhvilluar një punë e madhe lobuese me vendet anëtare të Këshillit Ekzekutiv dhe të vetë UNESCO-s për bashkë-sponsorizimin e kërkesës sonë për përfshirjen e aplikimit për anëtarësim të Kosovës në rendin e ditës së Këshillit Ekzekutiv. Si rezultat i kësaj fushate, 47 vende bashkë-sponsorizuan kërkesën e vendit tonë, një shifër e larte kjo për një procedurë të tillë.

Kërkesa e vendit tonë është përfshirë tashmë në rendin provizor të ditës që do të miratohet gjatë seancës së parë plenare të Këshillit Ekzekutiv, rreth datave 20-22 tetor 2015. Nuk përjashtohet mundësia që ndonjë delegacion, të kërkojë një votë procedurale për ta hequr atë pikë nga rendi i ditës. Ndaj, po punohet edhe në ketë drejtim për ta rrëzuar me votë këtë pretendimin, nëse do të ndodhë.

Votimi i Projekt-Rezolutës së Shqipërisë në Konferencën e Përgjithshme të UNESCO-s, e cila do të mbahet në datat 03-17 nëntor 2015, në Paris, do të bëhet i mundshëm në rast se Bordi Ekzekutiv jep rekomandim pozitiv. Votimi në Konferencën e Përgjithshme është i vlefshëm me 2/3 e votave "pro" ose "kundër", ndërsa abstenimet nuk llogariten. Gjithmonë llogaritet numri i pjesëmarrësve në seancë.

Ministria e Punëve të Jashtme është duke studiuar qëndrimet e vendeve të ndryshme për të mundësuar parashikime sa më objektive në lidhje me qëndrimin e tyre gjatë votimeve si në Këshillin Ekzekutiv ashtu edhe në Konferencën e Përgjithshme.

Procesi Një OKB - Shqipëria mbështet procesin "Një OKB" si një qasje koherente për forcimin e aftësive të saj për t'iu përgjigjur më mirë dhe në mënyrë më efiksase sfidave të ndihmës për zhvillim të OKB-së. Delivering as One ka rezultuar një praktikë ndihmëse për të sjellë më pranë programet e OKB-së me prioritetet kombëtare të secilit vend, si një mënyrë efikase për të zbatuar ndihmën për zhvillim, duke reduktuar ndjeshëm kostot e organizatës dhe programet e saj. Gjenerata e dytë e DaO është në mënyrë konstante e përqendruar dhe e orientuar tek rezultatet nëpërmjet forcimit të llogari-dhënies, monitorimit dhe vlerësimit. Në formë mjaft të përmbledhur disa nga arritjet e Programit të Bashkëpunimit me OKB-në në kuadër të reformave janë:

-Reforma territoriale iniciuar nga qeveria dhe mbështetur fuqimisht nga UNDP;

-Reforma sociale, kujdesi dhe përfshirja sociale, sidomos për romët (UNICEF dhe agjenci të tjera të OKB-së);

-Reforma drejt mësimit të hershëm (parashkollor) dhe zhvillimit të fëmijërisë;

-Mbështetje për politikat e punësimit (pakteve territoriale të punësimit në Shqipërinë e Veriut), etj.;

-Ekspertiza për kapitujt e ndryshëm të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014-2020, në treguesit dhe kornizën e monitorimit;

-Ekspertizë për finalizimin e disa strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale (dhjetë ose më shumë) dhe planeve të ndryshme të veprimit.

Bashkëpunimi i ardhshëm me OKB-në synon kryesisht :

-Reforma Territoriale dhe Administrative;

-Reforma e Administratës Publike;

-Reforma e Drejtësisë;

-Përfshirja sociale dhe barazia gjinore;

-Punësimi i rinisë.

Shqipëria ka shprehur vullnet për të marrë pjesë si vend pilot në projektin për Qeverisjen e mirë e arritjen e Objektivave të Zhvillimit të qëndrueshëm, që sapo u miratua në Nju-Jork. Nëpërmjet mbështetjes së OKB-së ne synojmë sigurimin e suksesit në reformat që qeveria po zbaton si pjesë të objektivit të Qeverisjes:

i. Sigurimin e shërbimit më të mirë përmes një qasje centric citizen të qeverisë, pra ofrimin e shërbimeve publike të përgjegjshme dhe transparente;

ii. Luftë korrupsionit dhe informalitetit, trafikut të drogës dhe krimit të organizuar;

iii. Modeli ekonomik i rritjes me një fokus në rritjen e balancuar ekonomike rajonale, me synim përfshirjen e tij në strategjitë afatgjata të zhvillimit të qëndrueshëm të Shqipërisë, duke siguruar punësim dhe përfshirje sociale;

iv. Modernizimi i administratës publike në nivel qendror dhe lokal.

Së fundi kandidatura e Shqipërisë në Këshillin e Sigurimit

Edhe pse vend anëtar i OKB-së që prej vitit 1955, Shqipëria bën pjesë tek ai grup i vogël vendesh të cilat nuk kanë shërbyer asnjëherë në organin më të rëndësishëm në sistemin e OKB-së, Këshillin e Sigurimit. Përpjekja e parë për t'u bërë anëtar jo i përhershëm i KS, ka qenë në vitin 1995.

Kandidatura e Shqipërisë për një vend jo të përhershëm në Këshillin e Sigurimit të OKB-së është paraqitur për periudhën 2022-2023, zgjedhjet të cilat zhvillohen në tetor 2021. Deri në këtë moment, kandidatura jonë mbetet e vetme dhe pa konkurrim brenda Grupit të Vendeve të Evropës Lindore, çka për momentin na vendos në një pozicion komod edhe pse për t'u zgjedhur në KS duhet të sigurohen 2/3 e votave të Asamblesë së Përgjithshme.

Pritshmëritë tona:

Mbetet thelbësore sigurimi i sa më shumë mbështetjeve me shkrim për këtë kandidaturë. Këto mbështetje vijnë kryesisht si shkëmbim reciprociteti.

Deri në këtë moment vendi ynë ka mbyllur 45 marrëveshje me shkrim për mbështetje reciproke. Po punohet që numri i tyre të shtohet duke përdorur lobimin e fuqishëm si dhe instrumentin e reciprocitetit, kjo është një sipërmarrje e vështirë por e realizueshme.

Ju faleminderit!

Arta Dade: Faleminderit Zoti Gjoka për informacionin gjithëpërfshirës. Kolegë pyetje?

Aldo Bumçi: paraprakisht më vjen mirë që gjatë Asamblesë, gjatë takimit të shtatorit në OKB nuk pati ngjarje si vitin e kaluar, ku Ministri i Jashtëm i Shqipërisë bojkotoi fjalën e Presidentit. Besoj e mbani mend, një ngjarje e paprecedentë, një ngjarje e turpshme që Ministri i Jashtëm të bojkotojë fjalën e kreut të Shtetit, e kreut të delegacionit në OKB, vjet në shtator. Është e vërtetë që si thoni dhe ju, më vjen mirë që takimet kanë qenë të shumta

por nuk duhet të harrojmë që statura dhe autoriteti i një vendi vlerësohet nga ... Shqipëria shkonte në OKB si vendi që ka prodhuar azilkërkues gati njësoj si Siria. Kjo është statura me të cilën Shqipëria shkonte në OKB. Nuk shkonte as një partner i vyer, sepse nëse prodhon për Gjermaninë dhe vendet e tjera të Bashkimit Europian azilkërkues sa Siria që është 4 vjet në luftë civile, më thoni me çfarë autoriteti dhe me çfarë respekti shkon Shqipëria? Me asnjë autoritet dhe respekt. Pse qytetarët e këtij vendi detyrohen që të largohen me mjera, në gusht janë larguar 8300 qytetarë shqiptarë si azilkërkues. Azilkërkues do të thotë njerëz që u shkelen të drejtat, por edhe të drejtat minimale ekonomike, siguria e jetës. Kjo është statura me të cilën ka shkuar Shqipëria në OKB.

Ju thoni se Kryeministri ka patur një aktivitet të ngjeshur, intensiv, por shqiptarët mbajnë mend vetëm një lajm, lajmin që prodhoi nga zëri i Amerikës ku siguronte Metën se nuk ka asgjë, pra lajmi nga Nju Jork nuk ishin takimet dhe promovimi i interesit të Shqipërisë por ishin qetësimi i Ilir Metës për çështjen e CEZ-it. Këtë lajm mbajmë mend ne nga intervista e Zërit të Amerikës dhe sulmi që i bëri gazetarit të Amerikës se po krijonte mjegull.

Kam tre pyetje:

E para: gjatë muajit të kaluar Shqipëria mori një vendim që e devijoi atë nga qëndrimi historik i saj për të qëndruar në mënyrën e votimit, qëndrimet politike partnerëve tanë kryesorë SHBA dhe BE. Për çështjen e Palestinës në OKB Shqipëria nuk votoi përkrah SHBA, që votuan kundër, por Shqipëria nuk abstenoi as si abstenuan Gjermani, vendi më i rëndësishëm i BE, lokomotiva ekonomike, vendi që ka nisur procesin e Berlinit, nuk abstenoi as si abstenoi Anglia, një nga vendet më të rëndësishme për ndërhyrjen ndërkombëtare në Kosovë në vitin '99, një nga mbështetëset më të rëndësishme të interesit shqiptar. A mund të më thoni arsyet për këtë vendim, si e justifikoni ju për të votuar kundër linjës së partnerëve tanë kryesorë Amerikanë dhe Europianë?

E dyta: në qoftë se përmenden këtu aktivitetet në kuadër të harmonisë fetare nga Kisha Katolike në Shqipëri ka një ankesë të vazhdueshme që nuk respektohet marrëveshja e lidhur ndërmjet shtetit Shqiptar dhe Vatikanit për krijimin e një komisioni të përbashkët. I është drejtuar Ministrisë së Jashtme, ju e keni përcjellë në kryeministri. Ministria e Jashtme është autoriteti që duhet të mbajë marrëdhëniet dhe Kryeministria e përcjellin dhe nuk japin përgjigje dhe nuk ka shpjegim më shumë se një vit. Kërkohet nga Selia e Shenjtë që të ngrihet Komisioni i përbashkët për çështjet që kanë dhe ju nuk jepni përgjigje. A mund të më jepni një shpjegim pse ky qëndrim ndaj Kishës Katolike? Kur do i ktheni përgjigje?

Pyetja e tretë ka të bëjë me respektimin e Kushtetutës. A mundet Sekretari i Përgjithshëm, që është sot i pranishëm të na shpjegojë se mbi ç 'bazë ligjore ka kërkuar kthimin në atdhe të

Ambasadorit tonë në OSBE kur Presidenti i Republikës gëzon të drejtën Kushtetuese për të dekretuar dhe ç 'dekretuar një Ambasador? Ai është kthyer edhe pse Presidenti nuk e ka ç 'dekretuar. A është kjo një shkelje e rëndë dhe e vetëdijshme e kushtetutës? Mbi ç 'bazë ligjore është kthyer ambasadori? Duke e kërcënuar se do i ndërpritet rroga dhe mbështetja financiare.

Arta Dade: pyetja e tretë nuk ka të bëjë me rendin e ditës, besoj dje ishte e mjaftueshme diskutuam në mënyrë shteruese në lidhje me OSBE-në.

Aldo Bumçi: me këtë veprim asnjë ambasador nuk ka më nevojë të ç 'dekretohet nga Presidenti i Republikës.

Arta Dade: pyetje të tjera. PO zoti Islami

Kastriot Islami: E nis lidhur me qëndrimin që ka Ministria për anëtarësimin e Kosovës në UNESCO. Cila nga vendet e BE-së ka një qëndrim kundër ose skeptik ndaj anëtarësimit të Kosovës në UNESCO dhe çfarë negociatash ka bërë Ministria në mënyrë që të paktën vendet anëtare të BE-së të jenë pro anëtarësimit.

E dyta, po në lidhje me çështjen e anëtarësimit të Kosovës në UNESCO, ka një aktivizim të marrëdhënieve Shqipëri-Serbi dhe të takimeve të Kryeministrave Rama dhe Vucic. Ndërkohë që ka, të paktën në media, shpresoj të jetë i gabuar, një angazhim të Serbisë për të mos e lejuar këtë gjë. Nuk e di a është biseduar në nivel kryeministrash ose ministrash të jashtëm me Serbinë dhe çfarë është arritur konkretisht?

Çështja e dytë ka të bëjë rreth punimeve të OKB-së ka patur një takim, i vetmi takim dypalësh, midis kryeministrit Rama dhe Tsipras. Në dijeninë tuaj çfarë është biseduar për çështjen e kufirit dhe a ka një angazhim të pasur, kalendar veprimesh për t'ju qasur kësaj çështjeje. E dyta është çështja e emrave në kartat e identitetit të shqiptarëve. A është biseduar kjo çështje nëse nuk është e zgjidhur?

E treta po prap nga media, shpresoj mos jem i gabuar, është krijuar ideja që Greqia mund të mbaj një qëndrim pozitiv ndaj njohjes së Kosovës. Është biseduar kjo çështje në këtë takim?

Ka dhe një çështje që ndoshta duhet ta ngremë me anëtarë të tjerë të Komisionit, unë jam i detyruar duke qenë se kjo çështje ka qenë edhe në programin e qeverisë dhe është artikular me shumë optimizëm nga Ministri i Jashtëm në fillim të mandatit të kësaj qeverie lidhur më çështjen çame. Është biseduar kjo me zotin Tsipras dhe çfarë konkretisht është arritur për këtë çështje?

Çështja e tretë kam dhe disa pyetje konkrete në lidhje me atë që ngriti zoti Bumçi në lidhje me qëndrimin e Shqipërisë për sa i përket çfarë negocimesh konkrete, bisedash janë bërë me

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, cili ka qenë qëndrimi i tyre? Çfarë është biseduar dhe cili ka qenë qëndrimi konkret i Anglisë dhe po kështu edhe për Izraelin, është biseduar dhe cili ka qenë qëndrimi konkret për këtë çështje?

Në media ka dalë se ka patur një keqkuptim me një format ftese që është bërë Ambasadorëve të vendeve Arabe dhe Ambasadorit të Izraelit. Mund të kemi ndonjë informacion më konkret?

Një nga shpjegimet që është dhënë për qëndrimin që ka mbajtur Shqipëria është dhënë se është menduar në favor të anëtarësimit të Kosovës. Me cilat nga vendet Arabe gjatë negocimit keni biseduar? Cilat janë vendet arabe të cilët kanë marrë angazhim konkret ose kanë bërë premtim lidhur me çështjen e njohjes së pavarësisë së Kosovës? Faleminderit.

Arta Dade: faleminderit zoti Islami. Kolegë? Po zonja Leskaj.

Valentina Leskaj: Në fakt shumë pyetje u ezauruan, por duke u nisur nga tema e ditës e cila është pak më e fokusuar në marrëdhëniet e Shqipërisë me Kombet e Bashkuara desha të bëj një pyetje: juve thatë se kjo ka patur eficenze për sa i përket vetë OKB-së në kuptim edhe të kostove dhe të eficiences. Kush është impakti për Shqipërinë?

A mendoni që UNDP është kthyer në një agjenci ekzekutive të projekteve këtu, të cilat në qoftë se shikon fushën e veprimtarisë fillon që nga lufta korrupsionit, terrorizmi, fëmijët, gender, romët, projektet e infrastrukturës, strategjitë për zhvillimin deri në vitin 2020, është shumë e shtrirë do të thoja. Si e shikoni juve këtë veprimtari? A është kthyer në një agjenci ekzekutive të projekteve që në fakt janë projekte të donatorëve të tjerë. A ka patur eficience për Shqipërinë? Natyrisht kjo shtrirje e gjerë në të gjitha fushat që përmendët edhe juve, a mendoni që edhe vetë UNDP i ka këto kapacitete dhe a mendoni se Shqipëria i ka këto kapacitete që të paktën disa nga këto projekte t'i ekzekutojnë agjencitë lokale? T'i ekzekutojnë vetë shqiptarët, sepse nëse ne mendojmë se gjithë këto projekte do t'i ekzekutojë UNDP kjo do të thotë se ose Shqipëria nuk i ka gjithë këto kapacitete ose nuk mendojmë për të ardhmen.

Kastriot Islami: kam edhe një pyetje tjetër lidhur me takimin Tsipras - Rama. Ka patur një çështje që ka patur një farë kontradikteti mbi çështjen e Kishës së Dhërmiut. Është biseduar kjo çështje dhe a janë sheshuar keqkuptimet apo moskuptimet, qëndrimet të paktën në publik jo fort koherente midis palëve?

Arta Dade: faleminderit zoti Islami! unë kam një pyetje lidhur me anëtarësimin e Kosovës në UNESCO. Dihet që Presidenti Serb Nikolic ka dorëzuar një letër tek Ban Ki Moon. A është ndërmarrë një hap nga ana e diplomacisë shqiptare lidhur me këtë apo keni vendosur të

jepni përgjigje asimetrike duke lobuar me vendet që mund të marrin një vendim për anëtarësimin e Kosovës në UNESCO?

Duke vlerësuar të gjitha projektet që Organizata e Kombeve të Bashkuara ka në Shqipëri, do të doja nëse i takon Ministrisë suaj, besoj që i ndiqni projektet zhvillimorë a ka një shtrirje në të gjithë vendin apo përqendrohen vetëm në disa vende që ndër vite kanë pasur projekte? Ju folët për projektet e UN në Reformën territoriale, kuptohet që ka organizma të tjera të angazhuara në këtë reformë, deri kur do të vazhdojë dhe a parashikohen projekte të tjera pasi të përfundojë reforma territoriale?

Lidhur me arsimin do të isha e interesuar të dija konkretisht si realizohen projektet me pushtetin vendor edhe ne kuadrin e ndarjes së re territoriale apo edhe me organizma të tjera që e shtrijnë aktivitetin në të njëjtën fushë? Përmendët arsimin parashkollor, do isha e interesuar për këtë, dhe a ka programe të unifikuara me organizmat e tjera?

Shumë pyetje kanë të bëjnë me marrëdhëniet dypalëshe, mendoj të nisim fillimisht nga qëllimi për të cilin është thirrur mbledhja, lidhur me veprimtarinë e agjencive, dhe marrëdhëniet e Shqipërisë me OKB-së, pastaj kalojmë tek pyetjet që u bënë lidhur me marrëdhëniet dypalëshe.

Sokol Gjoka: faleminderit për pyetjet. Do të mundohemi të përgjigjemi, por kini parasysh që disa çështje nuk mund t'i trajtojmë hollësisht dhe gjerësisht në publik sepse kanë konfidencialitetin e tyre.

Për sa i përket çështjes së votimit për Palestinën, ai ishte një votim për një xhest simbolik, për vendosjen e flamurit të Palestinës, tashmë një vend vëzhgues i OKB-së dhe të Vatikanit në Selinë e OKB-së, veçanërisht në prag të sesionit të 70 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara. Votimi dhe gjykimi aty ka qenë i pa kondicionuar në këto kushte ne kemi patur kontakte me partnerë dhe aleatë dhe mbas votimit që kemi bërë ne, i cili bëhej fjalë vetëm për atë gjest simbolik, kemi pasur mirëkuptimin e partnerëve, ndërkohë që një logjikë, përveç disa qëndrimeve të tjera që na çoi në këtë veprim ishte precedenti për ta përdorur në rastin e Kosovës. Së shpejti Kosova do të ketë kërkesat e saj, natyrisht për anëtarësim në OKB, por mund të ndjekë dhe rrugën fillimisht si vëzhguese dhe pastaj për anëtarësim të plotë sepse gradualisht po arrin dhe njohjen ndërkombëtare dhe ndërkohë i njëjti skenar mund të përdoret edhe për vendosjen e flamurit të Kosovës në selinë e Kombeve të Bashkuara. Në këtë kuadër, natyrisht qëndrimin tonë për ekzistencën e dy shteteve ju e dini, është qëndrim stabël dhe nuk ka ndryshim me qëndrimin tonë për sa i përket çështjes në fjalë, ky vendim u mor veçanërisht për këtë gjest simbolik.

Nga kontaktet që kemi pasur me partnerët dhe aleatët tanë nuk kemi patur reagime të ndonjë karakteri.

Venera Domi: doja të shtoja gjithashtu se kjo ka edhe impaktin e vet dhe në fushatën lobuese që po bëjmë për anëtarësimin e Kosovës në UNESCO, pasi është një lloj gjesti të themi pozitiv dhe dashamirës ndaj Palestinës, ndërkohë kur Vendeve Arabe u kërkojmë votën e tyre për Kosovën. Pra ishte pjesë e fushatës lobuese që po bëjmë për anëtarësimin e Kosovës në UNESCO.

Qirjako Qirko: për pyetjen e zotit Bumçi lidhur me zbatimin e marrëveshjes me Kishën Katolike, më duhet të them që marrëveshja është prej disa kohësh dhe për herë të parë, madje me kërkesë të kryeministrit kemi ftuar në Ministrinë e Jashtme drejtuesit e Komunitetit Katolik në Shqipëri disa herë gjatë kësaj periudhe. Kemi dëgjuar për problemet e tyre, janë probleme kryesisht të karakterit pronësor, ju e dini çështja e pronave është ndër çështjet më të vështira në Shqipëri, sepse diku ka vendime gjykata që detyron komunitetin të lirojë ambiente, diku ka vendime të Komisionit të pronave që kanë hyrë në territoret e njohura historikisht si të Kishës. Pra në tërësinë e vet ashtu si është çështja e pronave një problem kompleks edhe problematika që paraqiten drejtuesit e kishës katolike në Shqipëri dhe avokati i Kishës Katolike në Shqipëri ishin kryesisht të kësaj natyre. Ajo që bëmë ne dhe vazhdojmë ta bëjmë, sepse ky është një proces, më duhet të theksoj që realizimi i këtyre të drejtave kryesisht në fushën pronësore nuk është diçka që zgjidhet me një dëshirë të mirë apo me një akt të vetëm së pari duhet të evidentohen problematikat. Pra ata dorëzuan një dosje të plotë të të gjitha pretendimeve pronësore që kanë dhe në varësi të kësaj ku këto të drejta pronësore u ishin atakuar atyre. Për këtë ne kemi njoftuar Kryeministrinë në vijimësi për çdo gjë që ne bëjmë në Ministrinë e Jashtme e informojmë sepse në mënyrë të pashmangshme ky bashkëpunim dhe zgjidhja e këtij problemi shumë të vështirë kërkon bashkëpunimin e disa organeve duke filluar që nga Ministria e Drejtësisë, Komisioni i kthimit të Pronave, Gjykatat e kështu me radhë. Jemi në fazën që po evidentojmë cilat probleme janë dhe mund të zgjidhen me një akt të ekzekutivit, cilat mund të zgjidhen me vendime të Komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronave dhe cilat mund të jenë probleme të pazgjidhshme dhe do të gjejmë një zgjidhje të tillë, e cila në asnjë rast të mos cënojë të drejtën e shenjtë të pronës. Përsëris se marrëveshja është prej disa vjetësh, është hera e parë që mblidhet dhe ka një impenjim për ta zgjidhur këtë problem të rëndësishëm. Nuk e di pse ngrihet si shqetësim sepse nga përfaqësues të kishës, të cilin e kam drejtuar unë këtë aktivitet, kemi dëgjuar vetëm falenderime, fjalë të mira dhe vlerësimet që më se fundi ky problem po hyn në rrugën institucionale. Kaq mund të them për këtë problem.

Sokol Gjoka: për procesin e anëtarësimit të Kosovës në UNESCO, cila nga vendet e BE-së kanë qenë kundër ose kanë patur problematika. Unë mund të them që puna për procesin e anëtarësimit të Kosovës në UNESCO ka kohë që ka filluar, natyrisht jemi në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Jashtme të Kosovës, me qeverinë e Kosovës, për të bërë jo vetëm kalkulimet por edhe hapat për veprim. Mund të them që nga vendet anëtare të BE-së, pothuajse ka një mbështetje të plotë, përveçse vendeve që nuk e njohin Kosovën. Madje ndonjë vend anëtar i BE-së i cili nuk e ka njohur Kosovën, jo vetëm që ka deklaruar votën kundër por bën edhe fushatë lobuese kundër pranimit të Kosovës në UNESCO, kështu që jemi fokusuar pikërisht edhe në këto vende, veçanërisht edhe në vendin konkret në mënyrë që të ndërpritet fushata lobuese kundër anëtarësimit të Kosovës, pavarësisht se ata këtë qëndrim e mbajnë për mosnjohje, për shkak të zhvillimeve të tyre të brendshme, por të paktën fushatën lobuese duhet ta ndërpresin. Po punojmë në disa qendra, po punojmë në aspektin dypalësh, po punojmë në aspektin shumëpalësh, po punojmë dhe me partnerët tanë në mënyrë që të eliminojmë sa më shumë pengesa në procesin e anëtarësimit te Kosovës në BE. Ashtu sikurse ka vende që nuk e kanë njohur Kosovën, vende anëtare të BE-së të cilat kanë dhënë shenja pozitive që do ta mbështesin anëtarësimin e Kosovës në UNESCO. Ky është një lajm i mirë në një farë mënyre sepse pastaj relakson edhe qëndrimet e tyre në raport me Kosovën. Mund të themi që nga 58 vende anëtare që ka bordi ekzekutiv, ose Këshilli ekzekutiv i UNESCO-s, ku do të kalojë procedura e parë për votim për rendin e ditës e më pas për kalim në Konferencën e Përgjithshme, 33 nga këto vende kanë njohur Kosovën, ky është një aspekt pozitiv. Ndërkohë që, si thashë edhe në raportimin tim, për procesin e mbështetjes së iniciativës sonë, për ta futur në rendin e ditës të Bordit ekzekutiv anëtarësimin e Kosovës në UNESCO, Shqipëria në këtë proces është mbështetur nga 47 vende, anëtare të Bordit ekzekutiv, por jo vetëm, edhe vende anëtare të UNESCO-s të cilat i kanë dhënë një impuls dhe një mesazh të fortë të gjithë vendeve të tjera anëtare të UNESCO-s, për mbështetjen e kësaj procedure. Megjithatë ne në këtë aspekt po punojmë në disa fronte. Po punojmë me vendet të cilat e kanë njohur Kosovën por ende nuk janë shprehur. Po punojmë me vende të cilat nuk e kanë njohur Kosovën por mund të marrim një votim, të paktën jo kundër, pra një abstenim ose mos pjesëmarrje në votim, që është një votë në favor të çështjes së Kosovës dhe veçanërisht me vendet të cilat nuk e kanë njohur Kosovën, e kanë deklaruar votën e tyre kundër që fatkeqësisht po bëjnë një fushatë. Në këtë kuadër ne po bashkëpunojmë fort edhe me partnerët tanë, aleatët tanë në mënyrë që ta mbështesin procesin të gjithë së bashku të kemi angazhimin e tyre të plotë. Nga quinti, që janë pesë vendet kryesore të Europës të cilët na janë gjendur pranë dhe mbështesin procesin, kemi një punë intensive edhe me vendet të

cilat janë vështirësisht të arritshme nga ne për shkak të largësive, pranisë tonë në ato zona, e me radhë, kështu që puna jonë në këtë drejtim është në të gjitha këto fronte. Si thashë edhe qeveria e Kosovës po bën një lobim të fuqishëm, qoftë nëpërmjet adresimeve të drejtpërdrejta të personaliteteve të Kosovës në drejtim të vendeve të veçanta por edhe në drejtim të organizatave të veçanta për ta mbështetur anëtarësimin e Kosovës në UNESCO. Përmend këtu edhe reagimet tona si ndaj deklarimeve publike të personaliteteve serbe ashtu edhe të përfaqësuesve të saj në UNESCO të cilët me një gjuhë shumë të papërshtatshme, me një etiketim të papërshtatshëm ndaj shqiptarëve, ndaj Kosovës kërkojnë ta pengojnë procesin por që në fakt po loz kontrabedalin për përpjekjet e tyre, në të njëjtën kohë ne po reagojmë në të gjitha institucionet ndërkombëtare, qoftë me deklarime të drejtpërdrejta qoftë me letra të veçanta për t'ju kundërvënë kësaj politike denigruese do të thoja ndaj shqiptarëve, dhe nga ana tjetër për të mbështetur kauzën e Kosovës, e cila meriton që të jetë anëtare e UNESCO-s.

Arta Dade: vendet e rajonit kanë ndonjë ndryshim qëndrimi?

Sokol Gjoka: vendet e rajonit, përveç vendeve që nuk njohin Kosovën, vendet e tjera janë shprehur pozitivisht, të paktën me votimin. Natyrisht disa prej tyre nuk kanë mbështetur iniciativën tonë për ta vendosur në rendin e ditës, por thonë nëse do të futet në rendin e ditës ne do të votojmë pro. Të gjitha vendet që janë përreth, që kanë njohur Kosovën, janë angazhuar.

Kastriot Islami: në takimin Vucic Rama është diskutuar çështja e anëtarësimit të Kosovës në UNESCO?

Sokol Gjoka: natyrisht që ne e kemi parashtruar për ta diskutuar si çështje, besoj duhet të jetë diskutuar. Deri tani akoma nuk jemi njohur me të gjithë tematikën. Serbia e ka deklaruar qëndrimin e saj, nuk pritet ndonjë ndryshim.

Arta Dade: letra e Nikolic drejtuar Ban Ki Moon, përveç të tjerave ishte aspak diplomatike, konfirmonte edhe një herë qëndrimet e klasës më ekstreme dhe më radikale në Serbi. Dhe nuk besoj që kryeministri Vucic do të bjeri ndesh në qëndrimet e tij me Presidentin.

Sokol Gjoka: me çfarë shikojmë është e njëjta linjë, sepse janë pothuajse të gjitha nivelet që janë të prononcuara, natyrisht ne këto i kemi mjaft mirë të nënvijëzuara, i kemi në ndjekje dhe kemi ndërmarrë hapa për reagimin ndaj tyre. Hapat janë konkret në reagime rast pas rasti qoftë edhe ndaj fjalës së Presidentit Nikolic gjatë Asamblesë së Përgjithshme, pothuajse gjysmën e materialit të tij ja kishte dedikuar kësaj çështjeje dhe me të njëjtat terminologjira kështu që reagimet tona janë në kohë reale.

Për sa i përket çështjes së Greqisë për njohjen e Kosovës, kemi parasysh vizitën e Ministrit të Jashtëm Kotzias zhvilluar para pak muajsh në mandatin e parë të ti, natyrisht lëvizjet dhe qëndrimet e tij ishin optimiste. U fol për një bashkëpunim më praktik, më konkret, midis të dy vendeve, kështu që shpresojmë që edhe vota e Greqisë në favor të Kosovës në UNESCO të jetë në këtë linjë, mesazhe konkrete të kohëve të fundit që ne i mirëpresim nga Greqia në raport me të gjithë procedurën e njohjes së Kosovës.

Për të gjitha këto çështje edhe në vazhdën e takimeve të ndryshme por edhe të Nju Jorkut është rënë dakord që palët t'i diskutojnë dhe të arrijnë në veprime konkrete për përqasjen e tyre dhe për zgjidhjen e tyre.

Sa i takon pyetjes lidhur me një takim që pritej të bëhej për Kosovën në UNESCO me vendet Arabe dhe më pas me Izraelin. Ka patur një problem teknik në komunikim ku është dhënë një informacion paraprak i cili ka qenë i gabuar, sepse janë abc e komunikimit me trupin diplomatik. Është rikuperuar, takimet janë zhvilluar, me Vendet Arabe dhe natyrisht edhe me Izraelin ku është kërkuar lobim, është kërkuar mbështetje për Kosovën dhe nga ana tjetër nuk ka patur më asnjë lloj qëndrimi të mëtejshëm apo të themi reagim negativ qoftë nga Vendet Arabe, qoftë edhe nga Izraeli. Dihet që një pjesë e mirë e Vendeve Arabe të pranishme edhe me Ambasada këtu e kanë mbështetur kandidaturën e Kosovës në UNESCO në të gjitha fazat e veta si në bordin ekzekutiv, kanë deklaruar dhe votën e tyre pro në konferencën e Përgjithshme, dhe natyrisht ne jemi në kontakt të vazhdueshëm me ta që kjo mbështetje të zgjerohet edhe në kuadër të organizatave ku ata veprojnë si dhe kontaktet që ata kanë me vendet e tjera për të arritur një mbështetje më maksimale.

Venera Domi: në kuadër të bashkëpunimit në fushën e asistencës me OKB-në projekti Një OKB do të thotë që të gjitha strukturat, të gjitha agjencitë janë të bashkuara, prandaj në këtë aspekt nuk është UNDP e cila zhvillon projektet në Shqipëri por është OKB-ja, janë të gjitha bashkë. Prandaj këto projekte mbulojnë një sferë më të gjerë. Në rastin e projekteve konkrete ato kanë impakt për shtetin shqiptar, kanë impakt për qeverinë, për shoqërinë civile për sa kohë që ...

Valentina Leskaj: nuk bëra pyetje për impaktin e projekteve unë, bëra pyetje për impaktin e One UN, sepse ju thatë që ka rezultuar efektive dhe eficiente për OKB-në. Pyetja ime ishte po për Shqipërinë?

Venera Domi: edhe për Shqipërinë është po ashtu efektive sepse në vend që të menaxhojmë projekte pra qeveria Shqiptare të menaxhojë projekte me UNDP, me UN Women me agjencitë e ndryshme të sistemit të OKB-së, si është një partner qeveria shqiptare, është një partner edhe i gjithë sistemi i OKB-së, krijon një lehtësi si në menaxhimin e

projekteve ashtu edhe në evitimin e mbivendosjeve të tyre apo dhe shpërndarjes në mënyrë kaotike të projekteve. Gjithçka mund të përmirësohet, gjithçka mund të rregullohet, ka gjithmonë gjera për të rregulluar, por neve besojmë se ky sistem ka qenë efektiv, të paktën ky ka qenë dhe feedback që na kanë sjellë si zyra e zëvendëskryeministrit ashtu edhe zyra e koordinimit të ndihmës pranë kryeministrisë të cilat janë për qeverinë shqiptare dhe institucionet përgjegjëse të cilat koordinojnë asistencën financiare për Shqipërinë. Në këtë aspekt ne mendojmë se është pozitive. Ka patur një zhvillim pozitiv për Shqipërinë dhe këtë mesazh kemi përcjellë edhe pranë institucioneve të OKB-së.

Në lidhje me çështjet e tjera po për bashkëpunimin, asistencën, projektet të cilat bëjnë pjesë në programin e bashkëpunimit me OKB-në, janë propozuar nga institucionet kompetente pra nga ministritë e linjës të cilat janë kompetente të fushës së tyre dhe ne si Ministri e Jashtme nuk kemi kompetencën dhe ekspertizën e nevojshme që t'i gjykojmë për projektin nëse ai është i nevojshëm apo jo dhe ku është më i nevojshëm për tu zhvilluar. Prandaj në këtë aspekt ne nuk jemi në gjendje të japim një informacion më të saktë, nuk jemi në gjendje të japim impaktin për fushat e ndryshme. Për shembull për projektet në fushën e arsimit do të jetë në gjendje Ministria e Arsimit të japë një informacion sepse ne na mungon ekspertiza për të vlerësuar impaktet që mund të kenë në fusha të ndryshme.

Valentina Leskaj: pyetja ime ishte shumë konkrete, jo vetëm për një projekt konkret. A mendoni që të gjitha projektet kanë kapacitetet për këtë shtrirje dhe e dyta a mendoni që këto të ekzekutohen nga institucione shqiptare, kjo është e rëndësishme, që të kalojnë dhe të ekzekutohen nga institucionet shqiptare. Kostot shqiptare janë më të ulëta dhe Shqipëria nuk duhet të vazhdojë të presë që të vijnë agjencitë për të ekzekutuar projektet.

Venera Domi: padyshim në qoftë se vihet re në çdo 5 vjeçar të bashkëpunimit fushat vijnë duke u tkurrur, aktualisht shteti shqiptar është duke negociuar. Ne programin e ardhshëm 2017-2020 po shikohet mundësia për kufizimin për një numër më të vogël fushash dhe ku projektet do të kenë mundësi të jenë më efektiv. Nuk mund të them se janë projekte të cilat i zbaton vetëm UNDP. Qeveria shqiptare është partner në këto projekte. Në përgjithësi projektet reflektojnë kërkesat që vetë institucionet, vetë ministritë e linjës përcjellin për nevojat që kanë ata për të patur financime apo asistencë ndërkombëtare.

Arta Dade: besoj kjo është përtej autoritetit të Ministrisë së Jashtme, për këtë është zëvendëskryeministri. Pikërisht për këtë ka patur dhe një veprimtari javën që kaloi dhe unë besoj që ka një ridimensionim të projekteve që organizmat që janë të pranishme në Tiranë e ka ndryshuar sferën e rolit të tyre ndër vite. Patjetër që do të vijë momenti që të kemi ne ownership në të gjitha projektet dhe ekspertizën ashtu sikurse tha dhe zonja Leskaj.

Kur përfundon angazhimi i organizmave për reformën territoriale? Jemi në një proces që bashkitë e reja do të marrin në dorëzim dhe të gjitha projektet në vazhdim.

Venera Domi: Nga Ministria e Pushtetit vendor nuk kemi ndonjë sinjal që të paktën për vitet e ardhshme të ketë ezauruar nevojat për asistencë. Kështu që besoj se edhe në vitet e ardhshme do të ketë nevojë për transferim tek pushtetet e reja vendore. Por besoj që edhe ato duke krijuar kapacitetet e tyre në mënyrë graduale pastaj asistenca do të tkurret.

Aldo Bumçi: shkurtimisht në lidhje me tre pyetjet: në lidhje me votën pro Palestinës dhe ndryshe nga votimi që bënë aleatët tanë strategjik, besoj është e ditur për të gjithë Kosova është sot e pavarur dhe njihet nga më shumë se 106-107 shtete. Për shkak të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Anglisë, Gjermanisë dhe vendeve të tjera Europiane. Po të mos ishte vullneti i tyre Kosova nuk do të ishte shteti më i ri në Europë dhe nuk do të kishte këtë njohje, pra çdo hap i bërë për njohjen e shtetësisë së Kosovës është falë ndjekjes së këtij boshti, SHBA-Europë. Ju dhatë një argument tjetër, që mund të avancojmë interesin e Kosovës, ta përdorim këtë votë për të avancuar interesin e Kosovës. Ka vetëm një mënyrë si mund të avancohet interesi i Kosovës, përherë një me SHBA-në dhe vendet kryesore europiane. Çdo frymëzim tjetër është i dëmshëm, Shqipëria të paktën duhet të abstenonte si pjesa dërrmuese e vendeve Europiane, mendoj se këtu është bërë një gabim.

Pyetja e dytë lidhur me marrëveshjen midis shtetit shqiptar dhe Kishës Katolike. Pyetja ishte për ngritjen e Komisionit të përbashkët, unë e di që i keni takuar, shqetësimi ka ardhur nga nivelet më të larta të kishës Katolike këtu, para pak ditësh. Pyetja ishte pse nuk ngrihet Komisioni i përbashkët dhe nuk morra përgjigje.

E treta lidhet me pyetjen që ju nuk u përgjigjët, a e njeh Ministria e Punëve të Jashtme kompetencën kushtetuese të Presidentit të Republikës për të ç 'dekretuar një Ambasador? A e njihni këtë kompetencë? Dhe rasti konkret me ambasadorin në OSBE e keni shkelur?

Sokol Gjoka: në lidhje me pyetjen e parë mendoj që jemi në të njëjtën linjë sepse partneritetet tona strategjike tashmë dihen dhe ato janë në agjendën e bashkëpunimit tonë dypalësh dhe shumëpalësh. Unë e shpjegova për rastin konkret, nuk ishte një votë e orientuar, nuk kishte ndonjë reagim më pas.

Aldo Bumçi: ju thoni nuk është e orientuar vota, por nëse SHBA dhe Gjermania votojnë në një mënyrë ne sipas kujt do ta orientojmë këtë votë? kur ju thoni nuk ka orientim pse ne shkojmë sipas orientimeve të tjera?

Arta Dade: Ka çështje që secili vend vendos sipas interesave të veta.

Sokol Gjoka: votimi është bërë vetëm për një gjest simbolik nuk është bërë për stade të tjera politike dhe motivacionin unë jua thash.

Arta Dade: Zoti Gjoka është i qartë shpjegimi. Po zoti Islami.

Kastriot Islami: ndoshta për arsye konfidencialiteti një sërë përgjigjesh ishin jo të plota. Lidhur me çështjen e UNESCO-s përshëndes të gjitha veprimet që janë bërë me qeverinë e Kosovës, besoj do jetë një hap i rëndësishëm në qoftë se do të arrihet me sukses. Si e konceptoj unë duhet të orientohemi nga rezultatet dhe nga suksesi dhe jo nga propaganda. Marrëdhënia dypalëshe Shqipëri Serbi është përshëndetur nga të gjithë. Duhet ndrequr marrëdhënia dhe në kuadrin bilateral por edhe rajonal sepse i bën mirë të gjithë rajonit. Me qenë se ka një komunikim është e mirë që ky komunikim të jetë në tavolinë dhe të prodhojë rezultat. Të mos kishim atë qëndrim agresiv për sa i përket anëtarësimit të Kosovës në UNESCO. Megjithatë shpresoj që në këtë linjë që po bisedohet, po bisedohet për të arritur rezultatet e suksesit.

Marrëdhëniet e Shqipërisë me Greqinë janë shumë të rëndësishme. Ndoshta janë më të rëndësishmet në rajon, për më tepër që Greqia, në 25 vjet ka qenë një aleat strategjik, dhe në programin e qeverisë ka një angazhim dhe një synim paksa utopik, duhen zgjidhur. Çështja më delikate është ajo e kufirit. Ka nevojë për një bisedë të nivelit të lartë ndaj pyeta nëse ka patur një angazhim për ta përshpejtuar këtë proces. Më duket pozitiv fakti që Greqia ka një orientim pozitiv për të njohur Kosovën.

Për sa i përket çështjes së Palestinës, pa dashur ta ngacmoj më shumë se zoti Bumçi, meqenëse çështja ka qenë simbolike mendoj se duhet të ishte trajtuar në një mënyrë më vizionare dhe më të thellë sepse mundet të krijohen keqkuptime. Shpresoj të japë një rezultat të paktën në këtë orientim. Në qoftë se Kosova ka arritur këtu ku është dhe Shqipëria, si anëtare e NATO-s, është falë një politike konstruktive dhe bashkëpunuese me partnerët strategjikë.

Shqipëria në këtë moment ka nevojë për asistencë të organizmave si BE, OKB, çështja e dekriminalizimit lidhet me sigurinë e vendit. Është vendi i parë në Europë që partnerët Europianë i kërkojnë të dekriminalizohet. Pjesëmarrja e OSBE-së duhet intensifikuar. Unë mendoj që OSBE-ja ka nevojë të rrisë pjesëmarrjen në çështje të rëndësishme që të optimizohet madje të maksimizohet raporti i projekteve që ka Shqipëria.

Arta Dade: faleminderit zoti Islami. Nëse nuk keni më gjë për të shtuar unë do të doja të falenderoj zotin Qirko, zotin Gjoka dhe zonjën Domi për gjithë shpjegimet që dhanë këtu, dua të vlerësoj punën që bën drejtoria dhe struktura përkatëse e Ministrisë së Punëve të Jashtme për marrëdhëniet e Republikës së Shqipërisë me Organizatën e Kombeve të Bashkuara, gjithashtu dua të vlerësoj dhe punën e misionit tonë në OKB, për punën me profesionalizëm dhe për gjithë atë gamë veprimtarish që ne ndoqëm por dhe Ministria e

Punëve të Jashtme na ka informuar lidhur me delegacionin e nivelit të lartë në Asamblenë e Përgjithshme të OKB. Lidhur me shqetësimin e OSBE-së, dihet që Ministri i Jashtëm ka patur një takim shumë të frytshëm dhe efektiv me Sekretarin e Përgjithshëm të OSBE-së. Keqinterpretime mund të ndodhin. Ridimensionimet e organizmave janë në agjendë ne varësi të zhvillimeve dhe konsolidimit të demokracisë, dhe agjendës Europiane që vendi ynë ka. Lidhur me marrëdhëniet me partnerët tanë strategjik, kemi marrëdhënie të shkëlqyera, dhe aktiviteti që u bë me Presidentin Obama është tregues i marrëdhënieve që Shqipëria ka me partnerët strategjikë si një vend kontributor dhe si një vend serioz në të gjitha çështjet që vetë organizmat ku ne jemi anëtarë po përballen dhe ne si pjesë e koalicionit të gjerë mbështesim çështjet e sigurisë.

Ju falenderoj për bashkëpunimin!

MBYLLET MBLEDHJA